



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM Nr. 18 datë 12.03.2010

**PËR MIRATIMIN E TREGUESVE TË PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT  
EKONOMIK PËR VITIN 2010 TË SH.A “UJËSJELLËS KANALIZIME“  
KORÇË**

Këshilli Bashkiak në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe të Udhëzimit Nr. 965, datë 11.12.2007 Për zbatimin e VKM “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës – kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore” pika V/7, pasi u njoh me mendimin e Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit dhënë me shkresë Nr. Prot. 7404, datë 18.12.2009, me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Nr. 2\_ mb 09/07, datë 22.12.2009 dhe pasi shqyrtoi relacionin dhe tabelat e programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2010 dërguar nga Sh.A UKKO me shkresë Nr. Prot. 60, datë 25.02.2010,

**VENDOSI**

1. Të miratojë treguesit kryesorë të programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2010 të Sh.A “Ujësjellës Kanalizime“ Korçë si vijon:


- |                               |                  |
|-------------------------------|------------------|
| 1. Të ardhurat nga aktiviteti | 219.440.000 lekë |
| 2. Shpenzimet gjithsej        | 216.700.000 lekë |

- |                               |                 |
|-------------------------------|-----------------|
| 3. Numri mesatar i punonjësve | 90              |
| 4. Fondi i pagave             | 55.000.000 lekë |

Të punohet me efektivitet në drejtim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet, arkëtimin të plotë të vlerës të ujit të faturuar si dhe për mirëadministrimin e shpenzimeve.

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR



GJERGJI PENDAVINJI

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP  
www.infocip.org